KONTAKTONI ME NE

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
Adresa: Rruga e Shkronjave, nr. 1 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

Tel: 029 232-140
Email: rektorati@uni-prizren.com

https://www.facebook.com/Uni.UkshiHoti/

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Programet e studimeve (Bachelor):

Programi: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Programi: Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Programi: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

PERSPEKTIVA E KARRIERËS

Fakulteti i Filologjisë në Prizren ka një traditë disa vjeçare. Prizreni me rrethin dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi kishin dhe kanë një traditë për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare, që përfshin periudhën para dhe gjatë humanizmit dhe të iluminizmit. Ky fakt është i dëshmuar edhe në rrugën shkencore, por është një shtyllë e fuqishme për vazhdimësinë e traditës hulumtuese dhe shkencore. Lidhshmëria tradicionale e shkollës shqipe ka vazhduar dhe është dëshmuar edhe në periudhën e Rilindjes Kombëtare.
Fakulteti i Filologjisë në Prizren vazhdon rrugëtimin për ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës shqiptare, por edhe zhvillimin e kulturave anglofone dhe gjermanofone.
Kjo njësi akademike ka tri programe të studimeve.

- Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
-
- Drejtimet e studimeve, orientohen në parimet e realizimit të plan-programeve, të cilat mbështeten në udhëzimet e Ligjit të Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës, në udhëzimet ligjore dhe administrative të MAShT-it dhe kryesisht mbështeten në Statutit e Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit.

NJOHURI SHKENCORE DHE EKSPERTIZA PRAKTIKE

Programet në nivelin baçelor në përgjithësi kanë për qëllim aftësimin e studentëve për të ushtruar profesionin e tyre. Tri programet për objektiv studimi kanë gjuhën dhe komunikimi, letërsinë dhe kulturën. Këto fusha pastaj zbërthehen në lëndët e veçanta që i zhvillojnë dhe i thellojnë shkathtësitë gjuhësore dhe letrare të studentëve si dhe i zhvillojnë shkathtësitë e tyre akademike, në mënyrë që të rrisin profesionalizmin në gjuhë dhe letërsi. Studentët do të aftësohen për mësimdhënie, komunikim të rrjedhshëm në qarqet akademike dhe jo akademike dhe do të përgatiten për t'u përballuar me sfidat që mund t'i hasin në tregun e punës.

Dekanati i Fakultetit të Filologjisë për mision dhe vizion të tij ka hapjen e programeve të reja si për nivelin themelor ashtu edhe për atë pasuniversitar.

Fakulteti i Filologjisë mban lidhje me fakultetet dhe universitetet e tjera, po ashtu edhe me institucionet studimore, kërkimore e shkencore brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Dekanati i Fakultetit të Filologjisë është dhe do të jetë në shërbim të studentëve.

Studimet në keto programe janë nivelit Bsc (4 vjecare), i organizur në 8 semestra nga 30 ETC, secili prej tyre, gjithsejt 240 ECTS.

Universiteti"Ukshin Hoti",në Prizren është pjese e. programit Erasmus+, ku ofrohen shumë munësi të shkëmbimit të stafit dhe studentëve me shumë vendet anëtare të BE-së